



Shoqeria Nd. "ERGI" sh.p.k
Adresa: Autostrada Elbasan Metalurgji km 3 Elbasan
Nr. Kontakti: +355 692084208
Nipt: K02727229P
E-mail: ergishpk@ergishpk.com

V E N D I M Nr.6
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
"ERGI" sh.p.k

Sot, në **Elbasan**, me datën **31 Tetor 2023**, u mbledh në selinë e saj në adresën : Autostrada Elbasan-Metalurgji km.3, numri i pasurisë 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, lagjja 28 Nentori, Rajoni nr.3, - **Elbasan**, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "ERGI" sh.p.k. sipas lajmërimit të bërë rregullisht për të shqyrtuar problemin e **zmadhimit** të kapitalit të shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "ERGI" sh.p.k. (nipt: K 02727229 P) në lidhje me zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, me unanimitet :

V E N D O S I :

1. Menyra e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë do të jetë :

Për fitimin e vitit ushtrimor të vitit **2022** (pjesërisht) dhe të pa tërhequr prej ortakëve të shoqërisë sipas pasqyrave financiare të shoqërisë të datës **31.12.2022** { nga **96,868,998** lekë totali i fitimit të vitit 2022, do të përdoret për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë vetëm vlera **75.000.000** lekë, diferenca e mbetur **21,868,998** lekë do të shpërndahet si dividend }.

2. Nga **1 (një)** kuotë kapitali që ka pasur shoqëria para këtij procesi zmadhimi, numuri kuotave do të mbetet **1 (një)** kuotë kapitali me vlerën nominale të rritur, të cilat do të jepen vetëm ortakut të vetëm të shoqërisë (dhe vetëm atij, pra nuk do të ketë nënshkrim kuotash nga persona të tjerë jo ortakë).

3. Vlera nominale e një kuote të kapitalit të shoqërisë nga **375.382.000,00** lekë që ishte para procesit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, zmadhohet për **plus 75.000.000** lekë pas procesit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Pas këtij procesi zmadhimi, vlera e një kuote të kapitalit të shoqërisë arrin vlerën **450.382.000,00** lekë.

4. Kapitali i shoqërisë nga **375.382.000,00 Lekë** që ishte para procesit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, zmadhohet për **plus 75.000.000** leke pas procesit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Pas këtij procesi zmadhimi, **vlera e kapitalit** të shoqërisë bëhet **450.382.000,00 Lekë**, i cili përbëhet nga:

Vlera e kapitalit në **Para** : **450.382.000,00 Lekë**,

Vlera e kapitalit në **Natyrë** : **0 Lekë**.

5. Pas **perfundimit** të procesit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "ERGI" sh.p.k. rezultojnë si më poshtë :

Kapitali i shoqërisë bëhet **450.382.000,00 Lekë**. **Kapitali** i shoqërisë është i ndarë në **1 (një)** kuotë kapitali. Kapitali dhe kuotat e shoqërisë zotërohen si më poshtë:

a. **z. Nuri Balla**, numri i kuotave të zotëruara **1 (një)** kuotë kapitali, ose **100 %** e kapitalit të shoqërisë e barabartë me **450.382.000,00 Lekë** të vlerës së kapitalit. Vlera e një kuote të kapitalit të shoqërisë ka vlerën **450.382.000,00 Lekë**.

6. Depozitim e akteve në Qendrën Kombëtare të Biznesit nga personi i autorizuar.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË `` ERGI `` sh.p.k.

